



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 693/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaçi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e kandidatit të pavarur Rufki Suma, nga Hani i Elezit paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratik e Kosovës, për shkak të presionit ndaj votuesve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e kandidatit për kryetar të Komunës në Han të Elezit, Rufki Suma kandidat i pavarur, e cila mban shenjë A.nr. 693/2021 e datës 18.10.2021, **ANULOHET** Procesi i Votimit për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, vetëm për kryetar Komune, për shkak të minimumit të integritetit të zgjedhjeve si rezultat i presionit dhe organizimit me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve.

II. URDHËROHET Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, ta përsërisë votimin vetëm për kryetar komune në Qendrat e Votimit (QV) Nr. 3301d, 3302d, 3303d dhe 3304d të gjitha në Komunën e Hanit të Elezit.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga kandidati të pavarur Rufki Suma i cili pretendon se gjatë netëve të fundit të zgjedhjeve lokale në Komunën e Hanit të Elezit simpatizantët e PDK-së, kanë bërë presion mbi qytetarët ku çdo qytetar e kanë përcjellë me veturë dhe i kanë bërë ultimatum që të mos futet nëpër shtëpi, pra po ashtu dyshojmë se janë shpërndarë mjete për blerje të votave. Parashtruesi i anesës thekson se e kanë lajmëruar Policinë e Kosovës por të njëjtit nuk kanë dalë për t'i shpërndarë turmën e njerëzve. Po ashtu edhe vizitat e simpatizantëve në vendvotime siç është Paldencë dhe Gorancë.

Sipas raportimit të vëzhguesve tanë të subjektit kandidati i pavarur Rufki Suma, jemi njoftuar se në ditën e zgjedhjeve kandidati për kryetar nga radhët e PDK-së, Mehmet Balazhi dhe kandidatët për kuvend komunal të këtij subjekti kanë vizituar të gjitha vendvotimet në Hanin e Elezit, në Seçishtë, Gorancë, Paldenicë. Fjalët që i kanë përdorur në vendvotime janë “ si jeni, a jeni lodh, a keni ndonjë problem”, kurse në korridor me votuesit “votoni nr.177 dhe numrat e kandidatëve”, këto shihen në kamerë por nuk dëgjohej zëri. Menjëherë pas pranimit të informatës në si subjekt e kemi njoftuar KKZ-në, dhe Policinë e Kosovës por nga të njëjtit nuk është ndërmarrë asnjë masë.

Ankesës i ka bashkangjitur CD, me video.

PZAP-i, me datë 20.10.2021 i ka dërguar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kërkesë për përgjigje në ankesë.

Në përgjigje në ankesë të datës 21.10.2021, Partia Demokratike e Kosovës deklaroi se ankesa përveç që është e pasafatshme është edhe e pa bazuar, pasi që me asnjë argument nuk është vërtetuar që janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i zbatueshëm edhe në zgjedhjet lokale, dhe Rregulla Zgjedhore Nr.11/2013, Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet si dhe Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013. Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike. Në vendvotimet e cituara si në ankesë është evidentuar proces i rregullt sipas procesverbaleve të hartuara dhe nënshkruara nga kryesuesit dhe anëtarët e Komisioneve që e kanë administruar procesin përfshirë edhe komisionarët e kandidatit që është ankuar. Ndërsa lidhur me pretendimin tjetër se kandidati Mehmet Ballazhi ka vizituar tri qendra të votimit dhe ka bërë presion ndaj votuesve janë të pasakta për arsye se i njëjti në cilësinë e kryetarit të degës ka inkurajuar vëzhguesit të respektojnë rendin dhe ligjin dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen e procesit.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet ankimore se në ditën e votimit në qendrat e votimit të cekura në ankesë ka pasur presion ndaj votuesve, e po ashtu ka pasur organizim për të votuar dhe blerje të votës për të votuar Subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës, respektivisht kandidatin Mehmet Ballazhi, Paneli gjeti se këto pretendime janë të besueshme dhe të qëndrueshme, pasi nga provat e dorëzuara vërtetohet qartë se ka pasur organizim dhe shpërblim për të votuar kandidatin e Partisë Demokratike të Kosovës, gjë që kjo vërtetohet nga mesazhet e dorëzuara si provë, ku në njërin mesazh përmendet organizimi dhe shpërblimi, ndërsa në tjetrën fotografimi i votës si përgjigje në raport me kërkesën dhe përmbushjen e obligimit në shenjë respekti.

Paneli, me rastin e vendosjes si në pikat -I- dhe -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohen me nenin 117 par.3 të LZP-së, në të cilën përcaktohet se: *“Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, siç edhe ishin në rastin konkret. Po ashtu pikat e lartpërmendura të dispozitivit, Paneli i ka bazuar edhe në nenin 120 par.1 pika b), i LZP-së, në të cilin përcaktohet se: *“Para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP-it, në raste të jashtëzakonshme të anuloi rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhëroj KQZ-në, të përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale”*. Në këtë rast Paneli, vlerëson se vetë fakti i mënyrës së organizimit të votimit, presionit dhe përmendja e shpërblimit qoftë ky shpërblim në emër të organizimit apo blerjes, mesazhi me konfirmimin e votës për kandidatin fitues atë të Partisë Demokratike të Kosovës, rezulton se ka pasur ndikim në procesin e votimit dhe mund këtë ndikim rezultatin përfundimtar. Në Komunën e Hanit të Elezit deri me tani numri i votave të vlefshme është 4,874, ndërsa këtu kandidati i PDK-së ka fituar me 50,98 %, ankuesi me 42,47% ndërsa kandidati i tretë me 6,54 %, pra diferenca në përqindje në mes të kandidatit fitues dhe dy kandidatëve tjerë (ankuesit dhe kandidatit të tretë) është 1,97 % e që nëse përkethehet me vota nënkuptohet 96 vota, ndërsa nëse zberthehet edhe më tutje, vota të mjaftueshme në përqindje për t'i ikur balotazhit diferenca është në 0,985 %, ndërsa në vota është 48 vota. Një diferencë e tillë e votave në raport me kandidatin fitues duke marrë për bazë provat që dëshmojnë organizimin dhe mënyrën e organizimit, presionit dhe përmendja e shpërblimit qoftë ky shpërblim në emër të organizimit apo blerjes, mesazhi me konfirmimin e

votës për kandidatin fitues si dhe rrethanat tjera, është bazë e mjaftueshme për të përsëritur votimin, pasi çdo vendimmarrje ndryshe nënkupton shtrembërim të vullnetit të votuesve, dhe mungesë e legjitimitetit, ndërsa në instancë të fundit cenim dhe minim të integriteti zgjedhor.

Pretendimi i subjektit politik me përgjigje në ankesë se ankesa është e pasafatshme, si i tillë është i pabazuar për arsye se duke ju referuar shkresave të lëndës rezulton se ankesa është e afatshme dhe e lejuar.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha kundërshtimet e subjektit politik të dhëna me përgjigje në ankesë mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në pikën -I- dhe -II-, të dispozitiviti të këtij vendimi.

Vendimi i Panelit, është vendim administrativ sipas LZP-së, me të cilin nuk paragjykohet sanksionimi penal që mund të pasoj, sipas nenin 120 par.5 të LZP-së.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 dhe 120 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.693/2021 më datën 21.10.2021

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.